



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

NJOFTIM

PËR

**SHPREHJE INTERESI PËR ANËTAR TË KOMITETIT KËSHILLIMOR PËR
HARTIMIN E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT 5-VJEÇAR TË TREGJEVE
FINANCIARE NËN MBIKËQYRJEN E AMF-SË**

Në zbatim të nenit 15 të Ligjit Nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ndryshuar me Ligjin nr. 54/2014, Kryetari i Bordit të AMF-së do t’i propozojë Bordit ngritjen e Komitetit Këshillimor, me qëllim hartimin e politikave për mbarëvajtjen e punës së Autoritetit.

Komiteti Këshillimor do të veprojë si një Grup Pune me kohë të pjesshme dhe do të bashkëpunojë me strukturat e përhershme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ministrinë e Financave, Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën e Shqipërisë, tregjet nën mbikëqyrje, bankat tregtare, stafet akademike dhe universitare, shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit, dhomat dhe shoqatat e biznesit, etj. Komiteti Këshillimor do të ketë si qëllim hartimin e strategjisë 5-vjeçare të zhvillimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrjen dhe rregullimin e AMF-së.

Tregjet kryesore ku do të përqendrohet dokumenti i zhvillimit strategjik afatmesëm janë: pensionet private vullnetare, tregjet e kapitalit dhe tregu i sigurimeve.

Kriteret që duhet të plotësojë anëtari i Komitetit Këshillimor janë si vijon:

- 1- Të ketë kryer studimet universitare dhe pasuniversitare në ekonomi dhe/ose jurisprudence;
- 2- Të ketë eksperiencë pune në tregjet financiare, kryesisht për tregun e sigurimeve, tregun e kapitalit dhe tregun e pensioneve private vullnetare.

Kandidatët për anëtar të Komitetit Këshillimor mund të shprehin interesin në adresën zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare¹ **deri më datë 03.07.2017, ora 12.00**, duke depozituar:

1. Letër motivimi drejtuar AMF-së;
2. Diplomat për studime universitare dhe pasuniversitare;
3. Kopje të librezave të punës;
4. Letër rekomandimi nga punëdhënësit e tjerë, dhe
5. Dëshmi të penalitetit.

¹ Adresa: Rruga "Dora D'istria" Nr. 10, P.O. Box 8363, Tiranë, Shqipëri,
Tel: + 355 - (0) - 4 - 2257560, Faks: + 355 - (0) - 4 - 2250686, e-mail amf@amf.gov.al